

20060130181

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR GARANCINË E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR
PROJEKTIN PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT ENERGETIK NGA BANKA
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Neni 1

Në Ligjin për garancinë e Republikës së Maqedonisë sipas Marrëveshjes për hua për Projektin për përmirësimin e sistemit energjetik nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 20/98), titulli i Ligjit ndryshohet si vijon:

“Ligji për garancinë e Republikës së Maqedonisë sipas Marrëveshjes për hua për Projektin për përmirësimin e sistemit energjetik që do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe SHA për prodhimin e energjisë elektrike në pronësi shtetërore “Centralet elektrike të Maqedonisë”, Shkup”.

Neni 2

Në nenet 1, 2 dhe 3 fjalët: “NP Elektroekonomia e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “SHA për prodhimin e energjisë elektrike në pronësi shtetërore “Centralet elektrike të Maqedonisë” Shkup”.

Neni 3

Pas nenit 3 shtohet neni i ri 3-a, si vijon:

“Neni 3-a

Për një pjesë të mjeteve nga huaja sipas Projektit për përmirësimin e sistemit energjetik që do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe SHA për prodhimin e energjisë elektrike në pronësi shtetërore “Centralet elektrike të Maqedonisë”, Shkup, ndërsa të cilat do të shfrytëzohen nga ana e SHA EEM dhe SHA EPMSO për shfrytëzimin dhe kthimin e mjeteve të shfrytëzuara për investimet, të cilat me transformimin e SHA EEM janë nën kompetencën e tyre.”

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si vijon:

“Ministria e Financave dhe SHA për prodhimin e energjisë elektrike në pronësi shtetërore “Centralet elektrike të Maqedonisë”, Shkup do të lidhin marrëveshje me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella në bazë të garancisë të lëshuar për Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim nga neni 2 i këtij ligji.

Nëse obligimet e arritura në bazë të kamatës dhe të kryegjësë, në afatet e përcaktuara me marrëveshjen për hua, në emër të SHA për prodhimin e energjisë elektrike në pronësi shtetërore “Centralet elektrike të Maqedonisë”, Shkup, i paguan Republika e Maqedonisë, ministri i Financave mund të lëshojë urdhëresë në Drejtorinë e Hyrjeve Publike për bllokimin e mjeteve të SHA për prodhimin e energjisë elektrike në pronësi shtetërore “Centralet elektrike të Maqedonisë”, Shkup, në bazë të kthimit të TVSH-së me qëllim që të paguhen obligimet e arritura ndaj kreditorit, përkatësisht t’i kompensohen shtetit mjetet në denarë në lartësi të pagimit të bërë, të zmadhuara për kamatën e përlllogaritur dhe për shpenzimet e paraqitura lidhur me transaksionin përkatës.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.